

Hapet thirrja për bursa studimi për studentët e UMT, në Universitetin e Warmia dhe Mazuri në Olsztyn, Poloni në kuadër të programit Erasmus +

Mobiliteti dhe kohëzgjatja e bursave:

Studentët do të studiojnë semestrin e parë të vitit akademik 2026-2027 në Universitetin “Warmia dhe Mazuri” në Olsztyn, Poloni.

Kush mund të aplikojë:

Mund të aplikojnë studentët e UMT të cilët gjatë vitit akademik 2026-2027 do të jenë në vitin e dytë dhe të tretë, të ciklit bachelor si edhe studentët e vitit të parë dhe të dytë master, në:

- Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës

***Mund të aplikojnë vetëm studentët e degës së Inxhinierisë së Ndërtimit.

Ju mund të gjeni listën e lëndëve që zhvillohen në anglisht në universitetin pritës për semestrin e parë duke klikuar në këtë link: <http://www.site.uwm.edu.pl/en/study-at-uwm/course-catalogue/faculty-of-geoengineering>

Gjuha e mësimdhënies:

Mësimdhënia do të jetë në gjuhën angleze.

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (800 EUR në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- Kopje e pasaportës
- Vërtetim dhe Listë notash të ciklit aktual të studimit;
- Learning Agreement

** Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin Metropolitan Tirana kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë të vitit akademik 2026/2027 në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të jepni provim lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Metropolitan Tirana.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti dhe më pas në seksionin “sending university” firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit në UMT.

Afati për aplikim: 5 Qershor, 2026

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentet të skanuara me e-mail në adresën iro-projects@umt.edu.al ose dorazi në Drejtorinë e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Universitetin Metropolitan Tirana.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro-projects@umt.edu.al

UMT ju uron shumë suksese në aplikimin tuaj!